

**Abteilung Schulsozialarbeit**

Pionierstrasse 7  
8403 Winterthur

Telefon 052 267 40 77  
www.schule.winterthur.ch

**Soziale Schularbeit (Puna sociale shkollore) Winterthur****Një vendtakim për nxënëset, nxënësit, prindërit dhe personelin mësimor****Kush jemi ne**

"**Soziale Schularbeit**" (Puna sociale shkollore) (SSA) është një këshillimore neutrale dhe e pavarur. Ne jemi në vendin e ngajrjes për t'i zgjidhur problemet sociale dhe personale të fëmijëve dhe të të rinjve të caktuar si dhe për të njohur me kohë konfliktet brenda grupeve dhe për të vepruar me kohë.

Fëmijët dhe të rinjtë mund të vijnë tek ne pa paralajmërim.

Ne jemi poashtu vendtakimi i parë për prindërit, të cilët kanë fëmijë në shkollat e Qytetit të Winterthurit.

Ne i nënshtrohemi obligimit të ruajtjes së fshehtësisë. Ofertat tona janë sipas dëshirës dhe pa pagesë.

**Kështu mund të vini në kontakt me ne:**

- na telefononi që të mund të caktojmë një termin
- na shkruani një e-mail ose një letër
- emrat, numrat e telefonit dhe adresat e zyreve të punëtoreve/ punëtorëve socialë i gjeni në:

[www.stadt.winterthur.ch/schulsozialarbeit](http://www.stadt.winterthur.ch/schulsozialarbeit)

**Ne ju ndihmojmë**

... në rast konfliktesh mes nxënësve dhe nxënësve

... në rast problemesh në klasë

... në rast të brengave dhe gjendjeve të vështira personale të nxënësve dhe nxënësve

... në rast të vështirësive në familje

... në pyetjet mbi seksualitetin, varshmërinë dhe frikërat

Ne zhvillojmë biseda individuale apo në grup. Në rast konfliktesh brenda një klase, shkojmë në klasë dhe kërkojmë zgjidhje së bashku me fëmijët dhe të rinjtë.

Ne bashkëpunojmë ngusht me mësuesit dhe me qendrat e ndryshme profesionale. Ne ndërmjetësojmë në dhënien e adresave të qendrave profesionale, japim rekomandime dhe informacione.

**Qëllimi ynë**

Ne i ndihmojmë fëmijët dhe të rinjtë ashtu që të kenë mundësi që situatën e tyre në shkollë dhe përditshmërinë e tyre shkollore të mund ta ndërtojnë sa më pozitivisht dhe sa më me sukses si dhe të zhvillohen sa më mirë.